



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
FEDERATA SHQIPTARE E KARATESË**



**RREGULLORE TEKNIKE  
E  
ORGANIZIMIT TË GARAVE  
NË  
KARATE**

Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Federatës Shqiptare të Karatesë

---

## TABELA E LËNDËS

<b>DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....</b>	<b>3</b>
NENI 1. QËLLIMI.....	3
NENI 2. FUSHA E ZBATIMIT .....	3
<b>KOMISIONI I ORGANIZIMIT TË GARAVE .....</b>	<b>3</b>
NENI 3. VENDIMARRJA DHE ORGANET KOMPETENTE.....	3
NENI 4. KOMISIONI.....	4
NENI 5. STRUKTURA PËRBËRËSE E KOMISIONIT .....	5
NENI 6. KRYETARI.....	5
NENI 7. SEKRETARI .....	5
NENI 8. ANËTARËT .....	6
<b>ORGANIZIMI SPORTIV .....</b>	<b>6</b>
NENI 9. AKTIVITETET ZYRTARE .....	6
NENI 10. AFATET E REGJISTRIMIT .....	6
NENI 11. AKREDITIMI .....	7
NENI 12. ÇERTIFIKIMI MJEKËSOR.....	7
NENI 13. SHORTI I GARËS .....	7
NENI 14. BAZA MATERIALE .....	8
NENI 15. TAVOLINA ZYRTARE QENDRORE .....	8
NENI 16. TË DREJTAT E PJESËMARRËSVE .....	8
NENI 17. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E TRAJNERËVE.....	8
NENI 18. KOMISIONI I GJYQTARËVE .....	9
NENI 19. PAGESAT E GJYQTARËVE .....	9
NENI 20. MJEKU I VEPRIMTARISË.....	10
NENI 21. GRUPMOSHAT DHE PESHAT .....	10
NENI 22. RREGULLAT E PJESËMARRJES .....	11
NENI 23. PESHAT DHE KONTROLLI I TYRE.....	12
NENI 24. TAKSA E PJESËMARRJES .....	12
NENI 25. MASAT PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETIT .....	13
NENI 26. MBARËVAJTJA E GARAVE.....	13
NENI 27. FILLIMI I GARAVE.....	14
NENI 28. KLASIFIKIMI .....	14
NENI 29. STIMUJT .....	15
NENI 30. CEREMONIA E MEDALJEVE .....	15
NENI 31. MBYLLJA E AKTIVITETIT .....	15
NENI 32. DOKUMENTACIONI ZYRTAR I GARAVE .....	16
NENI 33. DËNIMET .....	16
NENI 34. PROTESTA .....	16
NENI 35. MANIPULIMET .....	16
NENI 36. DHUNA NË SPORT .....	16
<b>DISPOZITA TË FUNDIT .....</b>	<b>17</b>
NENI 37. INTERPRETIMI .....	17
NENI 38. HYRJA NË FUQI.....	17

Federata Shqiptare e Karatesë, me qëllim rritjen e shkallës së mirëfunksionimit dhe efektivitetit të veprimtarisë së saj, në përputhje me rregullat dhe parimet e Federatës Botërore të Karatesë, bazuar në Ligjin Nr. 9376 datë 21.04.2005 “Për Sportin” i ndryshuar, dhe në Statutin e saj miratuar me Urdhër Nr. 54, datë 25.02.2014 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit

## **VENDOSI:**

### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1. Qëllimi**

Kjo Rregullore Teknike e Organizimit të Garave në Karate (këtu e në vijim “**Rregullorja**”) rregullon mënyrën e organizimit, drejtimit dhe zhvillimit të veprimtarive lokale, kombëtare e ndërkombëtare në sportin e karatesë.

#### **Neni 2. Fusha e Zbatimit**

Rregullat e parashikuara në Rregullore janë të detyrueshme të zbatohen nga të gjithë subjektet që marrin pjesë ose janë të përfshirë në të gjitha veprimtaritë sportive të zhvilluara brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

### **KOMISIONI I ORGANIZIMIT TË GARAVE**

#### **Neni 3. Vendimmarrja dhe Organet Kompetente**

3.1 Federata Shqiptare e Karatesë (këtu e në vijim “**FSHK**”) është organizata e vetme, e cila ka të drejtën e organizimit të aktiviteteve sportive në sportin e karatesë, Kampionatin Kombëtar, Kupën e Republikës si dhe Kampionatin Mbarëkombëtar në Karate për Fëmijë, të Rinj dhe të Rritur, e drejtë kjo e dhënë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit si autoriteti më i lartë i sportit në Republikën e Shqipërisë.

3.2 Të gjitha veprimtaritë (Kampionate, Kupa, Turne, Memoriale, etj.) lokale, kombëtare e ndërkombëtare që organizohen nga shoqata sportive mund të zhvillohen vetëm me leje nga FSHK e cila përpiqet të vendosë në dispozicion mjete dhe personel nga Komisioni i Organizimit të Garave (këtu e në vijim “**Komisioni**”) për të ndihmuar në organizimin e veprimtarisë si dhe për të kontrolluar zbatimin e rregullave të garave sipas rregulloreve të miratuara nga FSHK.

3.3 Komiteti Drejtues i FSHK-së, i jep të drejtën e organizimit të garave Komisionit Organizimit të Garave i cili ngrihet për këtë qëllim.

3.4 Komiteti Drejtues i FSHK-së, zgjedh kryetarin e Komisionit dhe miraton përbërjen e tij.

3.5 Të gjitha veprimtaritë sportive në karate do të zhvillohen me miratimin e Komitetit Drejtues të FSHK-së dhe nën drejtimin teknik të Komisionit.

3.6 Kampionati Kombëtar dhe Kupa e Republikës për Fëmijë, paratërinj (Kadete), të rinj (Junior) dhe të rritur (Senior) në karate do të zhvillohet çdo vit në përputhje me kalendarin e aktiviteteve miratuar nga Komiteti Drejtues i FSHK-së.

3.7 Sekretari Përgjithshëm i FSHK-së, është personi që njihet i pari me materialet e Komisionit dhe ka të drejtë të vendosë mbi problemet e ligjshmërisë, organizative dhe financiare. Për çeshtje të caktuara, që bien ndesh me anën ligjore, organizative e financiare rigjykimi bëhet në të njëjtën mbledhje të Komitetit Drejtues.

3.8 Në rastet e pamundësisë së organizimit të mbledhjeve të Komitetit Drejtues të FSHK-së, projekt-vendimet e këtij Komisioni marrin fuqi ekzekutive dhe Komiteti Drejtues i FSHK-së ka të drejtën t'i rishikojë ato në mbledhjen e tij më të afërt pasardhëse.

3.9 Komisioni ka të drejtë të marrë vendime në bashkëpunim me Komisionin Teknik dhe Komisionin e Gjyqtarëve dhe të përpilojë programin teknik të ndeshjeve për aktivitetet kombëtare e ndërkombëtare që organizohen në Shqipëri.

#### **Neni 4. Komisioni**

Komisioni është organ teknik, i cili kryen këto funksione:

- a) Organizon aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare në territorin e Republikës së Shqipërisë në sportin e Karatesë;
- b) Siguron infrastrukturën e nevojshme për organizimin sa më normal të një gare në sportin e karatesë ku përfshihet (salla e pallatit të sportit, baza materiale, laptop, printera, qendër zëri, tavolina, karrige, podiumi i fituesve, flamuj, postera, diploma, medalje, suvenir, baner, kronometër, (tabela elektronike dhe masat e marra tekniko-organizative të domosdoshme si shortet, regjistrimin e sportistëve për garë, protokollat e ndeshjeve, mjekun e garave, ambulancë, etj.);
- c) Bashkëpunon me Shoqatat Sportive për organizimin e veprimtarive të Karatesë në rang lokal, kombëtar e ndërkombëtar, që zhvillohen në rrethet dhe qytetet e tyre;
- d) Përpilon buletin zyrtar të aktiviteteve dhe merr masa për sistemimin e ekipeve sportive në hotele, etj. (nëse i kërkohet nga kjo nga ekipet pjesëmarrëse);
- e) Merr masat e duhura për mbarëvajtjen, ruajtjen dhe sigurinë e rendit në sallën e zhvillimit të veprimtarisë si dhe kontrollon nëse plotësohen kushtet teknike;
- f) Zbaton programin sipas buletinit të aktivitetit për datat e caktuara si dhe oraret e zhvillimit të garave për të gjitha moshat dhe peshat që marrin pjesë në veprimtari;
- g) Ka përgjegjësi direkte për procesin e regjistrimit të sportistëve në gara si dhe për hedhjen e shortit dhe përgatitjen e protokolleve zyrtare të ndeshjeve;
- h) Përgatit ambientin e brendshëm në sallë, shtrimin e tatameve “arenave” dhe përcakton zonën e sigurisë për zhvillimin sa më normal të garës në përputhje me rregulloren ndërkombëtare;
- i) Dorëzon shortet dhe të gjitha materialet e nevojshme Komisionit të Gjyqtarëve dhe sekretarëve të garave përpara fillimit të zhvillimit të ndeshjeve. Procesi i zhvillimit teknik të garës (ndeshjeve) është kompetencë e Komisionit të Gjyqtarëve;
- j) Organizon ceremoninë e hapjes të aktivitetit sipas programit të përcaktuar në buletin zyrtar si dhe ceremoninë e ndarjes së medaljeve të fituesve;

- k) Arkivon të gjitha materialet e aktivitetit si dhe shpall zyrtarisht rezultatin përfundimtar. Materialet duhet të dorëzohen në Sekretarinë e Përgjithshme të FSHK-së brenda 3 ditëve nga përfundimi i aktivitetit.

### **Neni 5. Struktura Përbërëse e Komisionit**

Komisioni i Organizimit të Garave funksionon sipas kësaj strukture:

- a) Kryetari i Komisionit;
- b) Nënkyetari;
- c) Sekretari;
- d) Anëtar;
- e) Anëtar.

### **Neni 6. Kryetari**

Kryetari i Komisionit kryen këto funksione:

- a) Organizon, drejton dhe përgjigjet për punën e Komisionit pranë FSHK-së;
- b) Përfaqëson Komisionin në të gjitha mbledhjet e Komitetit Drejtues të FSHK-së dhe mbron vendimet e marra në Komision;
- c) Nënshkruan të gjitha dokumentet e lëshuara nga ky komision që vërtetojnë rezultatet përfundimtare të veprimtarive kombëtare dhe ndërkombëtare që organizohen nga FSHK;
- d) Thërret dhe drejton mbledhjen e Komisionit dhe zbaton vendimet e marra;
- e) Raporton para Komitetit Drejtues të FSHK-së sa herë që ky Komitet e sheh të arsyeshme.

### **Neni 7. Sekretari**

7.1 Sekretari është organi që kryen veprimet organizative për funksionimin e Komisionit të Organizimit të Garave është detyrë e Sekretarit të Komisionit, i cili kryen këto funksione:

- f) Përgatit mbledhjen e Komisionit të Organizimit të Garave;
- g) Kontrollon materialet e garave që do të shqyrtohen dhe vë në dijeni të gjithë anëtarët e tjerë të këtij Komisioni 3 ditë përpara ditës së organizimit të garës;
- h) Mban dhe përkujdeset për protokollin e mbledhjes dhe protokollet zyrtare të garave;
- i) Përgatit vendimet që merren në Komisionin e Organizimit të Garave, në bazë të formulimit të miratuar në mbledhje.

7.2 Materialet që shqyrtohen në Komision përgatiten në dy kopje, njëra i dërgohet Sekretarit të Përgjithshëm të FSHK-së dhe tjetra mbahet në dosjen e Komisionit.

7.3 Vendimet e Komisionit të Garave duhet të nënshkruhen nga Kryetari dhe Sekretari.

### **Neni 8. Anëtarët**

8.1 Anëtarët e komisionit të garave propozohen nga Kryetari i Komisionit dhe miratohen nga Komiteti Drejtues i FSHK.

8.2 Detyra e Anëtareve është të ndihmojnë në organizimin e të gjithë procesit të punës që ka të bëjë me rregullimin e ambientit ku do të zhvillohet gara dhe marrjen e të gjitha masave teknike të sallës.

8.3 Propozimin për shkarkimin e një anëtari të Komisionit e bën Kryetari i këtij Komisioni në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm të FSHK-së. Vendimi për shkarkim është kompetencë e Komitetit Drejtues të FSHK-së.

## **ORGANIZIMI SPORTIV**

### **Neni 9. Aktivitetet Zyrtare**

9.1 Federata Shqiptare e Karatesë përcakton kalendarin zyrtar të aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare që do të zhvillohen në vendin tonë gjatë vitit dhe i delegon Komisionit organizimin teknik të tyre.

9.2 Komisioni i Garave, mundësisht të paktën 1 muaj përpara datës së zhvillimit të aktivitetit kombëtar dhe 6 muaj para datës së zhvillimit të aktivitetit ndërkombëtar, përpilon dhe shpërndan buletin zyrtar ku duhet të përfshihen:

- j) Lloji dhe emërtimi i Aktivitetit;
- k) Data e zhvillimit të Aktivitetit;
- l) Vendi i zhvillimit të Aktivitetit;
- m) Përcaktimi i moshave dhe kategoritë e peshave që do të lejohen në këtë aktivitet, bazuar në përcaktimin e bërë në rregulloren e FSHK-së dhe WKF;
- n) Taksa e pjesëmarrjes miratuar nga Komiteti Drejtues i FSHK-së;
- o) Informacion për Akomodimin e të ftuarve në rastet e Aktiviteteve Ndërkombëtare dhe në rastet kur kërkohet nga pjesëmarrësit në aktivitetet kombëtare.

9.3 Buletini i garës duhet të dërgohet menjëherë së bashku me informacionin e mësipërm të gjithë anëtarëve të FSHK-së.

9.4 Federata është përgjegjëse për të bërë publikimin e aktivitetit në website zyrtar si dhe në mediat e shkruara dhe vizive.

### **Neni 10. Afatet e Regjistrimit**

10.1 Afati i regjistrimit të ekipit dhe sportistëve në garë do të jetë jo më vonë se 3 ditë para fillimit të aktivitetit kombëtar. Në rastet e aktiviteteve ndërkombëtare afati përcaktohet jo më vonë se 15 ditë përpara zhvillimit të aktivitetit.

10.2 Regjistrimi sportistëve mund të bëhet me postë elektronike ose nëpërmjet sistemit zyrtar sport data software të miratuar nga WKF. Pas mbylljes së afatit të regjistrimit, të gjithë sportistët pjesëmarrës do të regjistrohen në protokollin zyrtar.

### **Neni 11. Akreditimi**

11.1 Të gjithë personat që do të marrin pjesë në aktivitete ndërkombëtare dhe brenda mundësive dhe ato kombëtare do të pajisen me kartën e akreditimit bazuar në të dhënat personale të çdo individi ku do të përfshihen:

#### **Për sportistët:**

- a) Fotografi
- b) Emri dhe mbiemri
- c) Pesha dhe kategoria
- d) Datëlindja
- e) Gjinia
- f) Kombësia

#### **Për trajnerët dhe zyrtarët:**

- a) Fotografi
- b) Emri dhe mbiemri
- c) Pozicioni
- d) Kombësia

11.2 Akreditimi do të jepet gjatë regjistrimit dhe kontrollit të pasaportave të sportistëve për garë. Të gjithë ekipet pjesëmarrëse gjatë akreditimit duhet të paraqesin siguracionin shëndetësor.

### **Neni 12. Çertifikimi Mjekësor**

12.1 Për pjesëmarrje në veprimtaritë që organizon FSHK është e nevojshme që çdo sportist të kryejë kontrollin mjekësor pranë qendrave sportive të specializuara për këtë qëllim.

12.2 Trajneri është përgjegjësi kryesor dhe duhet të paraqesë kontrollin mjekësor që vërteton se sportisti është i aftë për të marrë pjesë në veprimtaritë e sportit të karatesë.

12.3 Federata Shqiptare e Karatesë nuk lejon në mënyrë kategorike pjesëmarrjen e sportistëve të cilët nuk paraqesin kontrollin mjekësor dhe siguracionin shëndetësor përpara zhvillimit të veprimtarisë.

12.4 Të gjithë pjesëmarrësit në gara duhet të nënshkruajnë një marrëveshje për pjesëmarrjen në gara ku pranojnë rrezikshmërinë që ka garimi. Në rastin e fëmijëve, kjo bëhet nga prindërit e tyre. Federata Shqiptare e Karatesë do të përjashtohet nga çdo detyrim ligjor në rast të një dëmtimi me pasoja të rënda për sportistët të cilët nuk janë të përgatitur nga ana psiko-fizike për të përballuar intensitetin e një gare në karate.

### **Neni 13. Shorti i Garës**

Hedhja e shortit të garës, bëhet të paktën 2 (dy) ditë përpara fillimit të aktivitetit me sistemin elektronik "sportdata" miratuar nga WKF. Shorti i përfunduar ju dërgohet të gjithë ekipeve pjesëmarrëse me email. Pas mbylljes së procesit të regjistrimit dhe hedhjes së shortit, një kopje e listave të garave ju shpërndahet klubeve pjesëmarrëse në

aktivitetet. Pas përfundimit të këtij procesi nuk lejohet të shtohen emra dhe ekipe pjesëmarrëse në listat e garave.

#### **Neni 14. Baza Materiale**

Federata Shqiptare e Karatesë siguron infrastrukturën e nevojshme për organizimin sa më normal të veprimtarive zyrtare dhe të detyrueshme të karatesë ku përfshihet (salla e pallatit të sportit, baza materiale, laptop, printera, qendër zëri, tavolina, karrige, podiumi i fitueve, flamuj, postera, diploma, medalje, suvenir, baner, kronometër, tabela elektronike dhe masat e marra tekniko-organizative të domosdoshme si shortet, regjistrimin e sportistëve për garë, protokollet e ndeshjeve, mjekun e garave, ambulancë, etj.).

#### **Neni 15. Tavolina Zyrtare Qendrore**

Në tavolinën zyrtare qendrore mund të ulen vetëm personat e autorizuar si vijon:

- a) Presidenti;
- b) Sekretari i Përgjithshëm;
- c) Drejtori Sportiv;
- d) Financieri i Aktivitetit;
- e) Kryetari i Komisionit të Organizimit të Garave ;
- f) Kryetari i Komisionit Teknik;
- g) Specialisti i IT-së;
- h) Kryetari Komisionit të Gjyqtarëve.

#### **Neni 16. Të Drejtat e Pjesëmarrësve**

16.1 E drejta e pjesëmarrjes në aktivitetet kombëtare është vetëm për anëtarët e licensuar të Federatës Shqiptare të Karatesë. Aktivitetete ndërkombëtare që do të organizohen në vendin tonë do të zhvillohen sipas rregulloreve të federatave ndërkombëtare ku FSHK aderon.

16.2 Numri i sportistëve pjesëmarrës në një kategori në aktivitetet kombëtare do të jetë pa limit, ndërsa në aktivitetet ndërkombëtare që do të zhvillohen në vendin tonë, numri i tyre përcaktohet sipas rregullores ndërkombëtare. Komiteti Drejtues i FSHK-së me vendim të veçantë mund t'i japë të drejtën e pjesëmarrjes në aktivitete kombëtare ekipeve që marrin statusin e anëtarit provizor deri në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të radhës.

16.3 Pjesëmarrja në aktivitetet kombëtare iu lejohet sportistëve të kualifikuar me brezin:

- Kumite: 6- KYU ( brezin e gjelbërt). Wado Ryu, Shito Ryu, Shotokan.
- Kata: 7- KYU ( brezi portokalli). Wado Ryu, Shito Ryu, Shotokan.

16.4 Për sportistët e stileve të tjera të Karatesë që kanë sisteme të ndryshme kualifikimi do të përdoret kualifikimi më i afërt me sa më lart. Sportistët që janë nën këtë kualifikimi nuk mund të marrin pjesë pasi aftësitë e tyre në njohjen e karatesë janë në fazën fillestare.

#### **Neni 17. Të Drejtat dhe Detyrimet e Trajnerëve**

17.1 Trajneri i ekipit është personi zyrtar që kontakton me drejtuesit e veprimtarisë. Vetëm trajneri zyrtar i akredituar nga Komisioni i Organizimit të Garave i një Klubi, Shoqate Sportive ose një individ do të lejohet të hyjë në zonën e garave.



Kodi i veshjes së tij është përputhje me rregulloren e arbitrimin të WKF miratuar nga Federata Shqiptare e Karatesë.

17.2 Trajneri i ekipit, të cilit i duket i parregullt gjykimi i ndeshjes, apo ndonjë vendim tjetër që dëmton sportistin apo ekipin e tij, duhet të reklamojë (ankimojë) me shkrim, bazuar në fakte konkrete, pranë kryegjyqtarit të veprimtarisë në përfundim të ndeshjes sipas rregullores së garave të WKF të miratuar dhe nga FSHK.

17.3 Trajneri i ekipit mban përgjegjësi për veprimet anti-sportive dhe të etikës të kryera nga sportistët dhe anëtarë të tjerë të ekipit të tij gjatë zhvillimit të veprimtarisë.

17.4 Trajneri duhet të paraqesë të gjithë dokumentacionin në lidhje me sportistët, përfshirë siguracionet shëndetësore, dokumentat identikues, liçensimet, autorizimet për pjesëmarrje në gara, etj.

### **Neni 18. Komisioni i Gjyqtarëve**

18.1 Në të gjitha veprimtaritë kombëtare të Karatesë, gjyqtarët përcaktohen nga Komisioni i Gjyqtarisë pranë FSHK-së. Gjyqtarët duhet të jenë me kategorinë kombëtare ose ndërkombëtare dhe të mbajnë uniformën e përcaktuar nga WKF, të jenë të pajisur me librezën e anëtarësisë së FSHK-së, të njohin mirë dhe të zbatojnë Rregulloren Ndërkombëtare të Gjyqtarisë si dhe të jenë kërkues e korrekt.

18.2 Gjyqtari duhet të mbajë rregull në sektorin ku gjykon, të mos pranojë sportistë me uniformë të parregullt, të mos debatojë me sportistë, trajnerë apo publikun etj., si dhe të gjykojë e të veprojë me kompetencë, sipas Rregullores Teknike dhe Rregullores së Veprimtarisë. Atij i ndalohet të vijë i pirë dhe të pijë duhan në ambientet sportive.

18.3 Numri i gjyqtarëve për një garë përcaktohet nga Komisioni i Gjyqtarëve dhe do të llogaritet sipas kofiçentit jo me pak se 6-gjyqtarë për 1- tatami (arenë), 1-pikëshënues dhe 1-sekretar protokollit.

### **Neni 19. Pagesat e Gjyqtarëve**

19.1 Në zhvillimin e garave në karate, personeli që shërben gjatë zhvillimit të tyre, do të shpërblehet financiarisht bazuar në VKM Nr.413 datë 11.06.2001 "Për gjyqtarët dhe vëzhguesit e sporteve të tjera jo me pak se 1500 lekë", sipas Tabelës Nr.1.

19.2 Në rastet kur aktiviteti zgjat më shumë se një ditë, kostot e pagesave llogariten sipas **Tabelës Nr. 1** duke i shtuar dhe ditët e tjera:

**Tabela 1**

<b>Aktivite Kombëtare</b>		<b>Aktivite Ndërkombëtare</b>	
<b>Kombëtar</b>	<b>Pagesa në 1-ditë</b>	<b>Ndërkombëtar</b>	<b>Pagesa në 1-ditë</b>
Judge B	3.000 lek	Judge B	40 euro
Judge A	4.000 lek	Judge A	50 euro
Referee B	5.000 lek	Referee B	60 euro
Referee A	6.000 lek	Referee A	70 euro

19.3 Lista e pagesave për personelin ndihmës që do të shërbejë në zhvillimin e veprimtarive llogaritet sipas **Tabelës Nr. 2:**

**Tabela 2**

Aktivitete Kombetare		Aktivitete Nderkombetare	
Pike Shënues	3.000 lek	Pike Shënues	40 euro
Mbajtës Protokolli	3.000 lek	Mbajtës Protokolli	40 euro
Mjek	5.000 lek	Mjek	50 euro

19.4 Për aktivitet kombëtare, të cilat zhvillohen në më shumë se një ditë, FSHK duhet të sigurojë akomodimin në hotel për gjygtarët që vijnë nga rrethet sipas ligjeve financiare në fuqi.

19.5 Për garat ndërkombëtare do të zbatohet Rregullorja Ndërkombëtare, e cila parashikon dhe detyrimet që ka FSHK për akomodimin e zyrtarëve të federatës ndërkombëtare, por duke u bazuar në ligjet financiare dhe vendimet e nxjerra për këtë qëllim.

#### **Neni 20. Mjeku i Veprimtarisë**

Gjatë organizimit të garave në karate duhet të jetë prezent ndihma mjekësore që përfshin mjekë specialistë dhe mundësisht të paktën një auto ambulancë të pranishme gjatë gjithë kohës së zhvillimit të aktivitetit, për çdo dëmtim të sportistëve gjatë garës.

#### **Neni 21. Grupmoshat dhe peshat**

21.1 Në të gjitha veprimtaritë e organizuara nga Federata Shqiptare e Karatesë për Kadetë, Junior, U21 dhe Senior zbatohet rregullorja e garave e miratuar nga WKF. Aktivitetet do të zhvillohen në sistem ekipor dhe individual sipas **Tabelës Nr.3, Nr.4** dhe **Nr. 5**.

Kategoritë dhe peshat e përcaktuara nga FSHK për fëmijë, kategoritë dhe moshat në konkurimin Kata përcakohen sipas **Tabelës Nr. 3:**

**Tabela 3**

7-VJEC		8-VJEC		9-VJEC		10-VJEC		11-VJEC		12-VJEC		13-VJEC	
Kata Ind		Kata Ind		Kata Ind		Kata Ind		Kata Ind		Kata Ind		Kata Ind	
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
Kata Ekipore								Kata Ekipore					

**21.2** Kategoritë dhe moshat në konkurimin Kumite përcakohen sipas **Tabelës Nr. 4:**

**Tabela 4**

8-VJEC		9-VJEC		10-VJEC		11-VJEC		12-VJEC		13-VJEC	
Kumite		Kumite		Kumite		Kumite		Kumite		Kumite	
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
-25	-25	-25	-25	-30	-30	-30	-35	-35	-37	-40	-42
-30	-30	-30	-30	-35	-35	-35	-40	-40	-42	-45	-47
-35	+30	-35	+30	-40	+35	-40	+40	-45	+42	-50	+47

+35		+35		+40		-45		-50		-55	
						+45		+50		+55	
60 Sekonda		60 Sekonda		60 Sekonda		90 Sekonda		90 Sekonda		90 Sekonda	

Kategoritë dhe peshat të përcaktuara sipas WKF paraqiten në **Tabelën Nr. 5:**

**Tabela 5**

CADET 14-15 VJEÇ		JUNIOR 16-17 VJEÇ		U 21 18-19-20 VJEÇ		SENIOR +18 VJEÇ	
Kumite Individuale		Kumite Individuale		Kumite Individuale		Kumite Individuale	
M	F	M	F	M	F	M	F
-52 kg	-47 kg	-55 kg	-48 kg	-60 kg	-50 kg	-60 kg	-50 kg
-57 kg	-54 kg	-61 kg	-53 kg	-67 kg	-55 kg	-67 kg	-55 kg
-63 kg	+54 kg	-68 kg	-59 kg	-75 kg	-61 kg	-75 kg	-61 kg
-70 kg		-76 kg	+59kg	-84 kg	-68 kg	-84 kg	-68 kg
+70 kg		+76kg		+84kg	+68kg	+84kg	+68kg
M	F	M	F	M	F	Kumite Team	
2 Minuta		2 Minuta		3 Min	2 Min	3 Min	2 Min
Kata Individuale		Kata Individuale		Kata Individuale		Kata Individuale	
M	F	M	F	M	F	M	F
		Kata Team +14				Kata Team +16	

## Neni 22. Rregullat e Pjesëmarrjes

22.1 Numri minimal i sportistëve në një kategori peshe nuk mund të jetë më i vogël se 2 pjesëmarrës. Në rastet kur kemi vetëm 1(një) sportist në një kategori, ky sportist do të ngjitet ose do të zbresë në kategorinë tjetër më të afërt në bazë të peshës së tij.

22.2 Në ndeshjet ku numri do të jetë 3 pjesëmarrës kjo kategori do të zhvillohet në sistem "rrethi", ku secili do të ndeshet me tjetrin pa sistem eliminimi.

22.3 Në rastet kur numri i pjesëmarrësve do të jetë 4 sportistë, 2 sportistët që eliminohen në raundin e parë do të zhvillojnë një ndeshje ndërmjet tyre për medalje bronzi. Në këtë rast përjashtohet automatikisht dhënia e dy medaljeve për vendin e 3-të. Të njëjtat rregulla do të ndiqen dhe në konkurrimin e katave.

22.4 Kur numri i sportistëve është më i madh se 8 sportistë, do të zhvillohet sistemi "repasage" për të përcaktuar fituesit e vëndit të 3-të duke zhvilluar ndeshje ndërmjet sportistëve që janë mundur nga dy finalistët.

22.5 Rregullat e mësipërme janë të detyrueshme të zbatohen në të gjitha garat zyrtare të organizuara nga FSHK.

### **Neni 23. Peshat dhe Kontrolli i Tyre**

23.1 Për verifikimin përpara fillimit të veprimtarisë, Komisioni i Organizimit të Garave kryen peshimin e të gjithë pjesëmarrësve sipas peshave që janë paraqitur në shortin e garave. Nuk lejohet asnjë tolerancë në peshë.

23.2 Sportistët që janë mbi peshë do t'u jepet një kohë e caktuar për të bërë një peshim të dytë. Në rast të evidentimit të paraqitjes së gabuar të një sportisti i cili është 5 kg mbi peshën e lejuar automatikisht do të përjashtohet nga ajo kategori. Komisioni do të vendosë nëse do t'i japë mundësinë e regjistrimit në një peshë më të madhe.

23.3 Kur pesha e sportistit është më e vogël se pesha e regjistruar për garë, ai menjëherë do të zhvendoset në peshën më të ulët e cila përputhet me peshën e tij. Dokumentacioni zyrtar i vihet në dispozicion Komisionit të Organizimit të Garave, të cilët përcaktojnë personat që do të zhvillojnë kontrollin e peshave për të gjithë sportistët që do të marrin pjesë në kumite.

23.4 Peshimi i sportistëve dhe kontrolli për çdo peshë dhe moshë do të zhvillohet 1 ditë përpara fillimit të aktivitetit në rastet e garave ndërkombëtare dhe përpara fillimit të garave në rastet e kampionateve dhe aktiviteteve kombëtare.

### **Neni 24. Taksa e Pjesëmarrjes**

24.1 Në çdo veprimtari kombëtare të organizuar nga FSHK, pjesëmarrësit janë të detyruar të paguajnë një taksë pjesëmarrjeje siç parashikohet në Tabelën Nr.6, sipas Vendimit të Komitetit Drejtues të FSHK.

**Tabela 6**

Kategoria Individuale	Gara në Kumite	Gara në Kata
Fëmijët	500 lek	500 lek
Kadetet	500 lek	500 lek
Junior	1.000 lek	1.000 lek
Senior	1.000 lek	1.000 lek
Kategoria Ekipore	Kumite Team	Kata Team
Femije	X	1.000 lek
Kadete	X	1.000 lek
Junior	2.000 lek	1.000 lek
Senior	2.000 lek	1.000 lek

24.2 Kjo taksë do të paguhet në financën e FSHK e cila duhet të lëshojë një faturë arkëtimi mbi shumën e paguar. ***Pagesa duhet të kryhet në bankë në numrin e llogarisë së FSHK-së dhe një kopje e mandatpagesës të paraqitet ditën e garës.***

24.3 Taksa e pjesëmarrjes në rastet e aktiviteteve ndërkombëtare përcaktohet nga rregullorja e federatës ndërkombëtare.

24.4 Taksa e garës për aktivitetet e hapura lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, që do të organizohen nga ana e Shoqatave dhe Klubeve Sportive, vendoset sipas vendimit të vetë organizatorëve.

### **Neni 25. Masat për Zhvillimin e Aktivitetit**

25.1 Përpara përcaktimit të vendit ku të zhvillohet aktiviteti, Komisioni verifikon gjendjen teknike të sallës dhe përcakton nëse plotëson kushtet teknike për zhvillimin e një aktiviteti sportiv në karate.

25.2 Shoqata apo Klubit Sportiv që bashkëpunon me FSHK-në në organizim përgjigjet për:

- a) Organizimin e veprimtarive në rang lokal, kombëtar e ndërkombëtar, që zhvillohen në rrethin ose qytetin e tyre;
- b) Merrjen e masa për sistemimin e ekipeve sportive në hotele etj., nëse i kërkohet nga ekipet;
- c) Zbatimin e datave dhe programit të ndeshjeve zyrtare për të gjitha moshat;
- d) Propogandimin e aktivitetit si dhe të Karatesë në përgjithësi;
- e) Kompletimin e gjyqtarisë me gjyqtarë vendas, që kanë kaluar nëpër seminare kualifikuese;
- f) Hartimin e zbatimit e kalendarit lokal, në një kohë të përshtatshme (30 ditë para veprimtarisë Kombëtare);
- g) Merrjen masave të duhura për mbarëvajtjen, ruajtjen dhe sigurinë e rendit në sallën e zhvillimit të veprimtarisë.

### **Neni 26. Mbarëvajtja e Garave**

26.1 Në ceremoninë e hapjes së aktivitetit zbatohet një protokoll i përcaktuar për këtë qëllim. Në fillim sinjalizohen të gjithë ekipet pjesëmarrëse, të cilët në mënyrë të rregullt dhe të kontrolluar, nën drejtimin e një anëtari të caktuar nga Komisioni, rreshtohen në sallën e pallatit të sportit në vendin e përcaktuar më parë.

26.2 Ekipet prezantohen me radhë nga spikeri i aktivitetit dhe mbajnë në krye një tabelë me emrin e ekipit ose shtetit pjesëmarrës.

26.3 Pas rreshtimit të ekipeve protokollin zyrtar ndiqet me këtë rend:

- a) Vendoset në audio Himni Kombëtar, 1 minutë ;
- b) Në sallë është ngritur (vendosur) në një pjesë të lartë Flamuri Kombëtar.
- c) Fjala i jepet Presidentit të Federatës.
- d) Ftohet një autoritet i lartë i Sportit, Ministri i Sportit, Presidenti i KOKSH dhe në rastet e aktivitetëve ndërkombëtare (Ballkanike, Mesdhetare, Europiane Botërore) fjala do t'i jepet dhe Presidentit të Federatës Ndërkombëtare, etj. për të përshëndetur dhe për të deklaruar hapjen zyrtarisht të aktivitetit nëse ka të ftuar të tillë.
- e) Mund të zhvillohet në një kohë prej 5-15 minutash një program artistik dhe demonstrime të Arteve Marciale.

26.4 Ceremonia e hapjes mund të zhvillohet në fillim ose gjatë zhvillimit të aktivitetit përpara ndeshjeve finale. Nuk lejohet që kjo ceremoni të zhvillohet në përfundim të aktivitetit.

### **Neni 27. Fillimi i Garave**

27.1 Pas mbylljes së procesit të peshimit dhe përpara konfirmimit përfundimtar të shortit, mund të bëhen ndryshime në listat e garave vetëm me vendim të Komisionit të Organizimit të Garave. Ky vendim bëhet publik për të gjithë pjesëmarrësit.

27.2 Gjatë këtij procesi ndalohet rreptësisht të shtohen emra të rinj të sportistëve dhe ekipe pjesëmarrëse në listat e garave.

27.3 Në rastet kur listat e shorteve janë jashtë sistemit online të sistemit sportdata vepron si vijon:

- a) Dokumentacioni (shorti i printuar) për fillimin e garave dorëzohet në sekretariatë e tatameve "arenave".
- b) Kryetari i Komisionit të Organizimit të Garave u dorëzon sekretarëve të arenave protokollet e ndeshjeve të cilat duhet të kenë zyrtarisht vulën e FSHK-së.

27.4 Në përfundim të garës në një kategori të caktuar, protokollet kthehen në tavolinën qendrore (të pastër dhe pa koregjime) të firmosura nga sekretari dhe gjyqtari përgjegjës i arenës "Kansa".

27.5 Në përfundim të veprimtarisë protokollet duhet të firmosen nga Kryegjyqtari, Kryetari i Komisionit të Garave dhe Sekretari Përgjithshëm i FSHK-së.

27.6 Në rastet e përdorimit të sistemit online të programit "sportdata" vetëm personat e autorizuar do të kenë akses në këtë proces.

27.7 Gjyqtarët e arenave kanë të drejtën e vendimit për ndeshjet që gjykojnë vetë, duke zbatuar Rregulloren Ndërkombëtare. Vendimet e gjyqtarëve në arena për përcaktimin e fituesit janë përfundimtare dhe nuk mund të manipulohen nga ana e sekretarisë ose Komisionit të Organizimit të Garave.

### **Neni 28. Klasifikimi**

28.1 Në veprimtaritë Kombëtare do të ketë klasifikim individual dhe ekipor sipas disiplinave kumite, kata, në kategoritë e moshave dhe peshave të paraqitura në tabelën e mësipërme.

28.2 Klasifikimi do të jetë deri në vendin e 3-të sipas sistemit olimpik dhe do të dalë në bazë fitoreve që ka çdo sportist sipas shortit të hedhur më parë e me eliminim gjatë zhvillimit të ndeshjeve.

28.3 Klasifikimi i fituesve dhe renditja e ekipeve për një lloj veprimtarie (Kampionat, Kupë, Memorial, etj.) do të bëhet mbi bazën e vendeve të para të marra në disiplinën (kumite, kata) në garat ekipore.

28.4 Në rast se veprimtaria do të zhvillohet në konkurim individual të moshave, kategorive dhe peshave, klasifikimi do të bëhet në bazë të medaljeve të fituara nga një ekip duke radhitur në fillim medalje Ari, Argjendi dhe Bronzi.

28.5 Nëse ka barazim të medaljeve të fituara, ekipi Kampion do të shpallet ekipi që ka siguruar më shumë pikë në ndeshjet e fituara gjatë procesit të eliminimeve.

### **Neni 29. Stimujt**

29.1 Për secilin fitues të tri vendeve të para për çdo disiplinë, kategori, moshë dhe peshë në klasifikimin individual do të jepen Diploma dhe Medalje.

29.2 Për ekipet fituese në Kata & Kumite ekipore (për secilën prej tyre) do të jepet medalje dhe një kupë dhe diplomë për ekipet fituese.

29.3 Për klasifikimin ekipor (për të gjithë veprimtarinë), do të jepen Kupa Medalje dhe Diploma për 3 ekipet të klasifikuara të parat sipas renditjes.

29.4 Kampionet Kombëtar mund të shpërblehen nga FSHK sipas ligjeve financiare në fuqi vetëm në rastet kur fondi i FSHK të jetë i mjaftueshëm dhe të përballojë këto shpenzime.

### **Neni 30. Ceremonia e Medaljeve**

30.1 Ceremoninë e ndarjes së Medaljeve e drejton Sekretari i Përgjithshëm i FSHK. Diplomat dhe medaljet gjatë ceremonisë jepen nga:

- a) Presidenti i FSHK-së;
- b) Të ftuarit e nderit;
- c) Anëtarë të Komitetit Drejtues të FSHK-së;
- d) Kryetarët e Komisioneve të FSHK-së;
- e) Presidentët e Shoqatave dhe Klubeve Sportive.

30.2 Gjatë zhvillimit të ceremonisë së medaljeve, fituesit duhet të paraqiten në podiumin e nderit me uniformën sportive të ekipit, klubit ose shoqatës sportive ose me uniformën tradicionale të karatesë "karate gi".

30.3 Nuk lejohet marrja e medaljes nga fituesi në rastet kur nuk plotëson kushtin e mësipërm. Nuk lejohet marrja e medaljes nga sportistët e tjerë të ekipit në rastet kur fituesi i medaljes nuk ndodhet në sallë dhe nuk është paraqitur për marrjen e saj. Në këtë rast medalja do t'i dorëzohet zyrtarisht trajnerit në sekretarinë qendrore të garave. Ndalohen rreptësisht shprehje dhe gjeste fetare gjatë zhvillimit të ceremonisë së marrjes së medaljeve.

30.4 Për të shmangur konfuzionin dhe rrëmujën gjatë ceremonisë medaljeve nuk lejohet që, trajnerët, të afërmit e sportistit dhe anëtarët e tjerë të ekipit të futen dhe ndërhyjnë në fotografimin zyrtar të fituesve në podiumin e nderit.

### **Neni 31. Mbyllja e Aktivitetit**

31.1 Në mbylljen e aktivitetit pjesëmarrësit do të lejohen të bëjnë fotografi në sallë dhe vendin e ceremonisë së medaljeve.

31.2 Mbetet detyrë e Komisionit Organizimit të Garave mbledhja dhe sistemi i të gjitha materialeve dhe magazinimi i tyre. Ruajtja dhe manaxhimi i bazës materiale

që shërben në organizimin e garave të FSHK-së, (Tatami, Tabelat Elektronike, Tv, LapTop, Fotokopje, Flamuj, etj.) është kompetencë e Komisionit të Garave.

### **Neni 32. Dokumentacioni Zyrtar i Garave**

32.1 Në përfundim të aktivitetit Komisioni Organizimit të Garave duhet të ruajë dhe administrojë të gjithë dokumentacionin zyrtar të garave. Brenda 3 ditëve duhet të bëjë publike zyrtarisht rezultatet e garave si dhe të dërgojë një informacion me shkrim në Sekretarinë e Përgjithshme të FSHK-së. Informacionin zyrtar me rezultatet e aktivitetit e dërgon zyrtarisht te të gjithë anëtarët e FSHK-së, Sekretari i Përgjithshëm.

32.2 Në informacion duhet të përfshihen:

- a) Tabela e ekipeve pjesëmarrëse.
- b) Numri i sportistëve pjesëmarrës femra, meshkuj.
- c) Tabela përfundimtare e renditjes sipas medaljeve të fituara.

32.3 Të gjitha garat e Karatesë që do të organizohen në Shqipëri për efekt arkivi historik, do të filmohen dhe fotografohen. Materialet do të ruhen në arkivën e FSHK-së. Është detyrë e Komisionit të Organizimit të Garave përcaktimi i personave apo kompanisë që do të merret me regjistrimin live dhe fotografimin e të gjithë aktivitetit me kamera dhe dorëzimin e materialeve të filmuara në FSHK.

### **Neni 33. Dënimet**

Klubet dhe Shoqatat Sportive të Karatesë, individët përbërës të tyre si dhe të gjithë personat e tjerë që përfshihen në strukturat dhe veprimtaritë zyrtare të FSHK-së, duhet të njohin dhe të zbatojnë të gjitha rregullat dhe vendimet e parashikuara në Rregulloren e Disiplinës dhe rregullore të tjera të miratuara nga FSHK-ja.

### **Neni 34. Protesta**

34.1 Nuk lejohet protestimi publik i çdo rasti që ka të bëjë me vendimet e FSHK-së dhe organizimin e garave prej saj.

34.2 Protesta që kanë lidhje me procesin e garës duhet të paraqitet në formë të shkruar menjëherë pas ndeshjes e cila është bërë shkak i protestës. Parashtruesi i protestës duhet të paguajë depozitim në shumën 5.000 lek.

34.3 Protesta dhe vërtetimi për pagesën e depozitës do t'i dorëzohen Komisionit të Organizimit të Garave. Përfundim i vetëm nga pagesa është kur protesta ka të bëjë me parregullsi administrative. Lidhur me procedurën e protestës do të zbatohet Neni 11 i rregullores së arbitrimit të WKF (versioni 9.0).

### **Neni 35. Manipulimet**

Anëtarëve të Komisionit të Organizimit të Garave ju ndalohet të marrin pjesë direkt ose indirekt në përpjekje për paracaktimin apo manipulimin e rezultatit të një ndeshje në aktivitetet e karatesë. Dënimet për rastet e manipulimit të ndeshjeve janë përcaktuar në Rregulloren e Disiplinës të FSHK-së.

### **Neni 36. Dhuna në Sport**

Gjatë veprimtarive sportive të të gjitha niveleve ose gjatë transmetimit të tyre në publik ose në mjedise ku ato zhvillohen ndalohet:



- a) Provokimi ose përpjekja për provokim me karakter politik, shoqëror, racia, fetar e gjinor, që synon nxitjen e urrejtjes e të dhunës ndaj pjesëmarrësve në veprimtarinë sportive ose/dhe ndaj spektatorëve.
- b) Ndalohet mbajtja dhe përdorimi në objektet sportive, gjatë zhvillimit të veprimtarive, i fishekzjarreve dhe i armëve të të gjitha llojeve, si dhe përdorimi dhe tregtimi i pijeve alkoolike.
- c) Personi, që merr pjesë në veprimtari sportive në cilësinë e gjyqtarit, është i paprekshëm. Ai është përfaqësues zyrtar i Federatës Shqiptare të Karatesë.

## **DISPOZITA TË FUNDIT**

### **Neni 37. Interpretimi**

Komiteti Drejtues i FSHK-së është i autorizuar të japë interpretime autentike të dispozitave të kësaj Rregulloreje.

### **Neni 38. Hyrja në Fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.